



02Nr. 5813 /2024
02.07.2024

Në bazë të Ligjit për Zyrarët Publikë Nr.08/L-197 në nenin 78 paragrafi 2, neni 80 dhe 81, Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068 neni 5 pika c, Ligjit të Punës Nr.03/L-212 neni 8 Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.05/2021 dhe 01/2022, Për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Komuna Hani i Elezit shpallë:

KONKURS

(Për plotësimin e vendit të punës me kohë të pacaktuar)

Institucioni: **Komuna Hani i Elezit**
Drejtoria: **Drejtoria për Arsim**

1. Titulli i vendit të punës: **Mësimdhënës/e i lëndës së Matematikës**
njësia/ sektori: **SHML "Dardania" 12 orë dhe SHFMU "Ilaz Thaçi" 4 orë**
Numri i pozitave: **Një (1) pozitë me afat të pacaktuar**
Koeficienti/Grada: **E17-5.8**

Detyrat dhe përgjegjësitë për Mesimdhënës/e :

Të realizoj planprogramin mësimor për vendin e punës , në harmoni me legjislacionin në fuqi, që të rregullojë fushat përkatëse për vendin e tij/saj të punës;
Të zbatoj detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mesimdhënies;
Të përgadit me rregull planin mësimor, në përputhje me Kurrikulën Bërthamë;
Të zbatojë metodologjitë e reja të mesimdhënies dhe vlersimit në përputhje me me Udhëzimet Kurikulare;
Të mbajë ditarin personal të vlersimit të nxënësve.
Të marrë pjesë aktive në organizimet jashtë mësimore me nxënës;
Të respektoj autoritetin e drejtpërdrejt të zyrtarit , të cilit i raporton dhe ti kryej detyrat që mund ti caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.

Kushtet e përgjithshme në rekrutim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotëroj të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët.
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse.
- Të mos jetë e/i denuar për kryerjen e veprës penale me dashje.
- Të mos ketë fuqi masë disiplinore për shkelje të rendë në institucion publik

Kualifikimi për Matematikë

- Niveli master arsimor-Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS)

Dokumentet e nevojshme:

- Formulari i aplikimit (merret në Komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë)
- Rezymeja personale (CV).
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë kopje).
- Diploma e kualifikimit (ose certifikata) duhet të jete kopje të vërtetuara.
- Certifikata që nuk jeni nën hetime (nga gjykata)
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Pranimi i aplikacioneve bëhet mbrenda tridhjetë (30) ditëve nga data 03.07.2024 deri 01.08.2024 nga ora 08:00-16:00

Të gjithë kandidatët e interesuar aplikacionin e punësimit mund ti marrin në formë fizike pranë Qendrës për Shërbime me Qytetarë në Han të Elezit kati i parë dhe të plotësuar e dorëzojnë në të njëjtin vend, apo ti shkarkojnë në portalin shtetëror <https://konkursi.rks-gov.net>
Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kriteret e konkursit nuk do të shqyrtohen ndërsa në faza tjera do të ftohen vetëm kandidatët që i plotësojnë kriteret e që futen në listë të ngushtë.
Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet, jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këto pozita, duhet që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura (nostrifikuara) nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me Udhëzimin Administrativ, nr.12/2018 të datës 10.09.2018, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Mirë priten aplikacionet e femrave dhe meshkujve të të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës
Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Konkursi dhe rezultatet shpallen në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/> në web faqen e komunës <https://kk.rks-gov.net/hanielezidhe> në tabelën e shpalljes.

Kryetari i Komunës
Mehmet Ballazhi

M. Ballazhi

